

Programi i shëndetësisë

A dëshiron që të ju japësh ndihmë dhe mbështetje njerëzve?

A dëshiron të provosh të punosh edhe gjatë kohës që je në gjimnaz?

A dëshiron të kërkosh punë direkt pas gjimnazit, por duke pasur mundësi që të studiosh më tutje?

A dëshiron të kualifikohesh për një fushë mësimore prej të cilës do të mund të gjejsh punë përherë?

A dëshiron të punosh në grup së bashku me të tjerë?

Atëherë Programi i shëndetësisë mund të jetë diçka për ty.

Te Programi i shëndetësisë do të mësosh bazat e shëndetësisë dhe të kujdesjes. Do të studiosh se në çfarë mënyre është i ndërtuar trupi i njerëzve dhe se si funksionon ai. Do të mësosh poashtu edhe se si të trajtosh situata që mund të ndodhin te vendi i punës.

Puna jote e ardhshme në shumicën e rasteve ka të bëjë me takime me njerëz dhe kuptim për njerëz që kanë rrethana të ndryshme jetësore, kulturore dhe fetare. Ndoshta do të ndesheni me njerëz që kanë shumë nevojë të ndihmë dhe mbështetje dhe që e kanë gjandjen të vështirë. Te Programi i shëndetësisë, mbi të tjera do të mësosh psikologji, që të mund të kuptosh mënyrën se si ne njerëzit mund të reagojmë kur përojmë për shembull një sëmundje ose pikëllim.

Të punosh ose t'i vazhdosh studimet

Nëse e zgjedh Programin e shëndetësisë mund të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit. Por ti mund të zgjedhësh të vazhdosh studimet në universitet ose në faklutet. Është më rëndësi që të zgjedhësh kurse në gjimnaz që të japin kompetencë për vazhdimin e studimeve. Në rast se që tani dëshiron të vazhdosh studimet, mund të pyesësh udhërrëfyesin e studimeve dhe të profesioneve se cilat kurse duhet të zgjedhësh nëse të nevojitet të kompletosh diçka.

Programi i shëndetësisë është një bazë e mirë nëse ke dëshirë që të vazhdosh studimet për kualifikime për shëndetësi akute, shëndetësi të hapur, shëndetësi psikiatrike, shëndetësi të fëmijëve, shërbim shtëpiak, vendbanime të posaçme për të moshuarit dhe të atyre me aftësi të kufizuara, shëndetësi preventive etj.

Punë ku mund të pranohesh

Pasi që e ka mbaruar Programin e shëndetësisë, mund të kërkosh punë si asistent infermjerësh, asistent shëndetësor dhe përkujdesës, kujdestar ose si asisten personal. Mund të vazhdosh studimet për infermiere dhe shumë profesione tjera në shëndetësi dhe kujdesje.

Përmbajtja e programit

Programi i shëndetësisë përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studjojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë të posaçme për Programin e shëndetësisë. Disa kurse i zgjadh ti vetë.

Programi nuk ka drejtime kombëtare, por ti mund të zgjedhësh një fushë të shëndetësisë e cila të intereson dhe mund t'i drejtohesh asaj fushë. Ti mund për shembull të studiosh punë

shëndetësore, shëndetësi për të moshuar, shëndetësi psikiatrike dhe përkujdesje, fëmijë dhe rrini, shëndetësi akute ose aftësi të kufizaur.

Në disa shkolla gjimnazi ka drejtime lokale të veçanta dhe programe të formuara posaqërisht. Kontakto me udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve nëse dëshiron të dijshtë se çfarë lloj drejtimesh ka aty ku ti dëshiron të mësosh.

Kontakti me tregun e punës

Te programi i shëndetësisë do të keni kontakte me tregun e punës gjatë kohës së gjimnazit. Do të keni kualifikim te vendi i punës (APU) për të paktën 15 javë. Kjo është një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte që mund t'i përdorësh kur kërkon punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do tu jepet.

Ardhmëri dhe punë

Do të jetë me siguri shumë lehtë për ty që të pranohesh në punë menjëherë pas Programit të shëndetësisë. Gjatë viteve të fundit ka pasur përafërsisht aq punë sa edhe të porsa kualifikuar. Në rast se bëhte lehtë apo rëndë për ty të pranohesh në punë mund të mvarret nga fakti që a je në gjendje që të shpërngulesh apo të udhëtosh në një vend tjetër. Disa nga komunat kanë tepër të holla dhe për këtë arsye mund të punësojnë më tepër personel shëndetësor se sa komunat tjera. Në ardhmëri do të ketë nevojë për shumë vende pune në shëndetësi. Kjo është për arsye se në Suedi do të ketë më tepër të moshuar dhe si pasojë nevojitet më tepër shëndetësi. Nëse i vazhdon studimet pas gjimnazit, ke mundësi shumë të mira që të gjejsh punë.